



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 2.10.2025

Nr. 6269 prot.

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator

E nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 19, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni se janë përgatitur projektvendimet si vijon:

1. Projektvendim "Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkitë Tiranë, Berat, Tepelenë, Cërrik, Mat dhe Vlorë, të datës 9 nëntor 2025".
2. Projektvendim "Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkitë Tiranë, Berat, Tepelenë, Cërrik, Mat dhe Vlorë, të datës 9 nëntor 2025".
3. Projektvendim "Për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të votuesve në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkitë Tiranë, Berat, Tepelenë, Cërrik, Mat dhe Vlorë, të datës 9 nëntor 2025".
4. Projektvendim "Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në Vendet e Numërimit të Votave në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkitë Tiranë, Berat, Tepelenë, Cërrik, Mat dhe Vlorë, të datës 9 nëntor 2025".

Propozoj thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e këtyre projektvendimeve.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimeve dhe relacioneve shoqëruese.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

